

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kumbarët e kokainës/ Nga Kolumbia e Ekuadori në Europë, si u trafikuan mbi 50 tonë drogë
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/27/kumbar-et-e-kokaines-nga-kolumbia-e-ekuatori-ne-europe-si-u-trafikuan-mbi-50-tone-droge/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 19:30:33 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 19:30:03 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	42216448eec6c2c3a67eed1eda10213596df34cf68f842802a81e8d355f6c8ac
TEKSTI	809f784affd63c73f43b98077764552f1e5e9d12acd92579ad261d38e5687498
PAMJA	947a3c071cbb61e34d835bf412d8d11e26c7371cd2c6752e0cd6165a649cecf2

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	4872746c6ba672ff867551f65d3a8703553492515a1523a6d071fa2148382ea8
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	3aac5177b059e894026952c5b076c374c5dd6b2fda5f20c0a9390b2c535810d8
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/4872746c6ba672ff867551f65d3a8703553492515a1523a6d071fa2148382ea8>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fillimi > AKTUALITET

Kumbarët e kokainës/ Nga Kolumbia e Ekuadori në Europë, si u trafikuan mbi 50 tonë drogë

21:30 : 27/09/2026 në AKTUALITET, KRONIKE, KRYESORE



Një rrjet që nisej nga Amerika Latine. Kontejnerë që udhëtonin mijëra kilometra nëpër oqean. Kokainë që hynte në portet e Europës.

Miliona euro që ktheheshin mbrapsht. Dhe në fund të kësaj rruge prona, kompani, vila, hotele dhe pasuri në Shqipëri.

SPAK thotë se pas kësaj strukture qëndronte një emër, **Shpëtim Aliu**.

I njohur në botën e komunikimeve kriminale si **Salvatore**.

Një 51-vjeçar nga Elbasani, i cili për vite me radhë qëndroi larg vëmendjes së publikut, ndërsa sipas hetimeve të SPAK dyshohet se kishte një rol qendror në furnizimin me kokainë të disa grupeve shqiptare.

Lexo edhe:

[Të pathënat e jetës së Alket Rizait, mes burgjeve të Greqisë dhe arratisjeve spektakolare](#)

[Përfshihet nga flakët banesa në Fier, humb jetën i moshuari](#)

Më 23 shtator 2026, ai u arrestua në Rusi. Por arrestimi i tij nuk është fundi i historisë. Është momenti kur një prej dosjeve më të mëdha të narkotrafikut ndërkombëtar të hetuara nga SPAK merr një tjetër dimension.

Sepse pas emrit Salvatore, dosja çon te dhjetëra tonë kokainë, te komunikimet e SKY ECC, te grupet kriminale që vepronin në vende të ndryshme të Europës dhe te qindra pasuri të vendosura nën sekuestro në Shqipëri.

Por kush ishte Salvatore? Sa e madhe ishte struktura që dyshohet se drejtonte?

Dhe si mund të kalonte një organizatë e tillë nga kokaina e Amerikës Latine tek pasuritë e paluajtshme në Shqipëri?

TË GJITHA




Kumbarët e kokainës/ Nga Kolumbia e Ekuadori në Europë, si u trafikuan mbi 50 tonë drogë

21:30 : 27/09/2026



"Krimi ka kokë"/ Protestuesit mesazh Ramës për skandalin e Vlora Hysenit

21:13 : 27/09/2026



Rokadë ambasadorësh/ Ferit Hoxha ndryshon përfaqësuesit, Meidani në Prishtinë, Malaj në Shkup

20:59 : 27/09/2026



"Arrestoni Ramën"/ Mbyllen fjalimet te Kryeministria, protestuesit marshojnë në rrugët e Tiranës

20:54 : 27/09/2026



Asgjë e re nga Edi Rama

20:35 : 27/09/2026



Të pathënat e jetës së Alket Rizait, mes burgjeve të Greqisë dhe arratisjeve spektakolare

20:24 : 27/09/2026



Përfshihet nga flakët banesa në Fier, humb jetën i moshuari

20:07 : 27/09/2026

Deri tani në dosjen e SPAK muret për të paktën 50 tone kokaine të trafikuar dhe milionë euro të pastruara nga këto grupe kriminale që ndërvepronin me njëra-tjetrën.

Më 23 shtator 2026, Shpëtim Aliu, i njohur si Salvatore, arrestohet në Rusi. Operacioni mban emrin “The Wanted” dhe zhvillohet në bashkëpunim mes Interpol Tiranës dhe homologëve rusë.

Për Aliun, GJKKO kishte caktuar më herët masën e sigurisë “arrest në burg”, në kuadër të hetimit të SPAK. Ndaj tij rëndojnë katër akuza: Trafikim narkotikësh, pastrim i produkteve të veprës penale, grup i strukturuar kriminal dhe kryerje e veprave penale në kuadër të organizatës kriminale ose grupit të strukturuar kriminal. Policia shqiptare njoftoi se arrestimi në Rusi është bërë me qëllim ekstradimin e tij në Shqipëri.

TRAFIKU I KOKAINËS

Në qendër të një prej hetimeve më të mëdha të SPAK për trafikun ndërkombëtar të kokainës shfaqen 4 emra në veçanti: Shpëtim Aliu, i njohur si Salvatore, Eldi Dizdari, alias Denis Matoshi, Dritan Gjika dhe Armando Pacani.

Katër persona që në dosjen hetimore shfaqen në pika të ndryshme të të njëjtit mekanizëm kriminal. Por rolet e tyre, sipas materialeve në dosje, nuk ishin domosdoshmërisht të njëjta. Aliu paraqitet nga SPAK si një prej figurave qendrore të strukturës: furnizues, organizator dhe financues i ngarkesave të kokainës nga Amerika Latine drejt Europës. Ai ishte pika e lidhjes me furnizimin dhe logjistikën e ngarkesave.

Por për ta kuptuar fuqinë e rrjetit, duhet parë edhe marrëdhënia me tre emrat e tjerë.

Eldi Dizdari, në komunikimet e zbardhura nga SKY ECC, shfaqet duke kërkuar sasi të mëdha kokaine nga Aliu. Jo kilogramë, por tonelata. Në një prej komunikimeve që janë të administruara në dosjen e SPAK, Dizdari i thotë Aliut se kishte tregun gati dhe kapacitetin për të përballuar sasi që arrinin deri në 10 tonë. Sipas raportimeve mbi dosjen, në pak ditë ai kishte transferuar të paktën 8 milionë euro drejt strukturës së Aliut për furnizimin nga Ekuadori.

Me Dritan Gjiken komunikimet tregojnë një marrëdhënie tjetër. Sipas dosjes hetimore, Gjika ishte i lidhur me sigurimin e kokainës në Amerikën Latine, ndërsa Aliu merrej me nxjerrjen e sigurt të ngarkesave nga portet dhe dërgimin e tyre drejt Europës. Në një episod të shtatorit 2020, sipas dosjes, Gjika siguron një ngarkesë prej rreth 1.1 tonësh kokainë, ndërsa Aliu organizon daljen e saj nga Ekuadori. Kur kjo ngarkesë përfundon e sekuestruar në Rotterdam, komunikimet nuk ndërpriten.

Përkundrazi, të dy diskutojnë për ngarkesa të tjera. Madje, në një komunikim të 7 tetorit 2020, Gjika pyet nëse do të kalonin paratë për “mallin” në Cali. Përgjigjja e Aliut është e drejtpërdrejtë: “1 milion.” Por komunikimet tregojnë edhe diçka tjetër. Jo vetëm trafik, edhe kontroll mbi cilësinë e produktit. Në disa biseda të publikuara, Aliu i ankohet Gjikës për cilësinë e kokainës që kishte mbërritur në Europë. Ankesat vinin nga njerëzit që e shisnin atë në tregun evropian. Gjika kërkon të dijë nëse kishte ndonjë detyrim financiar për t’u shlyer. Në një tjetër komunikim, Aliu i kërkon Gjikës të kontrollojë mënyrën e prodhimit, pasi një pjesë e “mallit” kishte dalë e dëmtuar.

Një tjetër emër që del në këtë rrjet është Armando Pacani. Dhe lidhja me Salvatore Aliun nuk mbetet vetëm në nivelin e një emri të përfshirë në të njëjtën dosje. Sipas komunikimeve të analizuara nga SPAK në platformën SKY ECC, Aliu, Eldi Dizdari dhe Armando Pacani përdornin kode të identifikuara nga hetuesit dhe komunikonin në lidhje me një ngarkesë prej rreth 700 kilogramësh kokainë. Bëhet fjalë për një episod të 11 majit 2020, kur droga u sekuestrua në portin Waasland të Antwerp-it, e fshehur në një kontejner me pjesë këmbimi automjetesh. Sipas materialeve të publikuara mbi dosjen, ky episod është një nga rastet ku emri i Pacanit shfaqet në komunikimet që lidhen me rrjetin e Salvatore Aliut. Pacani, ndërkohë, del në hetim edhe për ngarkesa të tjera të kokainës nga Amerika e Jugut drejt Europës. Ky nuk është një përshkrim i një organizate të provuar me vendim përfundimtar gjyqësor, por mënyra se si rolet dalin nga materialet hetimore të publikuara deri tani. Dhe pikërisht kjo e bën marrëdhënien mes tyre të rëndësishme. Lidhen me hallka të ndryshme të të njëjtit aktivitet: sigurimi i kokainës, financimi, transporti, nxjerrja nga porti dhe dërgimi në Europë.

Një zinxhir që, sipas hetimit, nuk përfundonte me drogën. Në fund të tij ishin milionat. Dhe pas milionave pasuritë në Shqipëri.

HETIMI QË NISI NË SHQIPËRI

SPAK e ka filluesën e këtij procedimi në një referim të Policisë së Shtetit në maj të vitit 2020. Hetimi më pas do të zgjerohet përtej Shqipërisë. Në Amerikën Latine, Belgjikë, Holandë, Francë, Mbretëri e Bashkuar dhe Shqipëri.

Sipas SPAK, Salvatore Aliu nuk ishte thjesht një person që shiste drogë. Dyshimi i prokurorëve ishte se ai kishte një rol shumë më lart në hierarki, ishte furnizues, organizator dhe financues i ngarkesave. Në këtë skemë, sipas dosjes së SPAK, grupet shqiptare nuk do të ishin domosdoshmërisht një organizatë e vetme me një strukturë tradicionale. Ato do të funksiononin si një rrjet. Grupe të ndryshme, persona të ndryshëm, vende të ndryshme, por me një burim furnizimi që, sipas hetimeve, lidhej me Salvatore Aliun.

Sipas SPAK, gjatë periudhës 2019–2021, rrjeti dyshohet se ka trafikuar të paktën 50 tonë kokainë nga Amerika Latine drejt Europës. Por këtu duhet bërë një dallim i rëndësishëm. SPAK raportohet se ka dokumentuar konkretisht pesë episode. Në këto pesë episode janë sekuestruar gjithsej rreth 8 tonë e 960 kilogramë kokainë.

Pjesa tjetër e shifrës prej 50 tonësh i referohet trafikut që hetuesit dyshojnë se është kryer gjatë periudhës së hetuar:

Më 11 maj 2020, në Antwerp, sekuestrohet 700 kilogramë kokainë, që ishte fshehur në një kontejner me pjesë këmbimi automjesh. Më 6 qershor 2020, në Guayaquil, në Ekuador, kapen 2 tonë e 10 kilogramë kokainë që kishte si destinacion Holandë. Më 16 gusht 2020, në Rotterdam kapet 1.1 tonë kokainë. Ndërsa më 16 dhjetor 2020, po në Rotterdam, kapet edhe një sasi tjetër, 4.1 tonë. Më 3 shkurt 2021, në Kolumbi kapet 1 ton e 50 kilogramë kokainë.

Pothuajse nëntë tonë kokainë të sekuestruar. Dhe sipas SPAK, dhjetëra tonë të tjera që dyshohet se kanë kaluar pa u kapur.

Një nga elementët më të rëndësishëm të hetimit janë komunikimet e enkriptuara të SKY ECC. Sipas materialeve që përmban dosja e SPAK, komunikimet janë siguruar përmes bashkëpunimit ndërkombëtar dhe letër-porositve. Dhe pikërisht këtu hetuesit pretendojnë se kanë gjetur mënyrën se si funksiononte mekanizmi.

Jo thjesht: “Ka ardhur droga.” Por edhe sa ishte sasia, nga ku ishte nisur, me çfarë kontejneri, në cilin port, si do të ndahej dhe kush do ta merrte. Në një nga komunikimet e publikuara, Salvatore Aliu dhe Eldi Dizdari diskutojnë për një ngarkesë prej rreth 6 tonësh. Dizdari kërkon që një pjesë të jetë në kontejnerë frigoriferikë dhe pjesa tjetër në kontejnerë të zakonshëm. Destinacioni transit përmendet Antwerp-i.

Këto nuk janë më thjesht biseda për drogë. Nëse përmbajtja e komunikimeve është interpretuar saktë nga hetuesit, ato tregojnë një nivel planifikimi ku diskutohet edhe mënyra e organizimit të ngarkesës dhe transportit të saj.

Ndërsa territori nga ku kalonte kokaina, ashtu siç përshkruhet në dosje është: Ekuador, Kolumbi, Belgjikë, Holandë, Francë, Mbretëri e Bashkuar, Shqipëri. Dhe pikërisht këtu qëndron një nga elementët më të rëndësishëm të historisë. Nuk kemi të bëjmë vetëm me një grup që dërgon drogë nga një vend në tjetrin. Sipas hetimeve, kemi një ndarje rolesh.

Në njërin anë furnizimi, në tjetrën financimi, më tej transporti. Pastaj marrja e ngarkesës, shpërndarja dhe në fund pastrimi i parave. Hetuesit e lidhin Salvatore Aliun me disa grupe kriminale shqiptare dhe emra të njohur të dosjeve të tjera të krimit të organizuar. Mes tyre përmenden Eldi Dizdari, Dritan Gjika, Armando Pacani, Jetmir Pepa dhe grupe të tjera.

Kokaina ishte vetëm njëra anë e historisë. Ana tjetër ishte paraja. SPAK dyshon se në Shqipëri janë pastruar të paktën 30 milionë euro të ardhura nga aktiviteti kriminal. Dhe këtu shfaqet një tjetër person kyç, Isa Aliu, vëllai i Salvatore Aliut.

Sipas materialeve hetimore, paratë dyshohet se hynin fillimisht në formën e cash-it dhe më pas qarkullonin përmes kompanive, huave, investimeve dhe pasurive të paluajtshme. Miliona euro. Paratë që duhej të fshiheshin, paratë që duhej të investoheshin dhe paratë që duhej të largoheshin nga gjurmët e aktivitetit kriminal.

Këtu historia ndryshon. Sepse organizata nuk kishte më nevojë vetëm për njerëz që të transportonin kokainën. Kishte nevojë për njerëz që ta kthenin kokainën në pasuri.

Më 15 qershor 2026, GJKKO vendosi sekuestro preventive mbi 491 pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme të lidhura drejtpërdrejt ose tërthorazi me personat nën hetim.

Mes tyre: 266 pasuri të paluajtshme, toka, apartamente, hotele, vila, garazhe dhe prona në

disa prej zonave më të kërkuara të vendit. Nga Tirana dhe Durrësi deri në Dhërmi, Himarë e Sarandë. Janë sekuestruar gjithashtu automjete, mjete lundruese, mjete transporti dhe 209 llogari bankare. Vlera totale e pasurive është raportuar rreth 150 milionë euro, por vetë SPAK ka theksuar se vlera e saktë duhet të verifikohet gjatë hetimit. Dhe ky është ndoshta numri që tregon më qartë se çfarë do të thotë krimi i organizuar modern. Nuk është vetëm droga. Është ekonomia që krijohet pas drogës.

Nëse gjithçka do të provohet në Gjykatë, fuqia e kësaj strukture kriminale ndërkombëtare nuk qëndronte vetëm te sasia e drogës. Ajo që e bënte të fuqishme ishte lidhja mes disa hallkave. Furnizimi, financimi, transporti, shpërndarja, komunikimi i koduar dhe pastrimi i fitimeve.

Një hallkë mund të ndodhej në Ekuador, një tjetër në Belgjikë, një tjetër në Holandë, dikush tjetër në Shqipëri dhe sipas hetimeve, këto hallka komunikonin dhe funksiononin si pjesë e të njëjtit mekanizëm. Ky është ndryshimi mes një trafikanti dhe një strukture kriminale ndërkombëtare.

Nuk është vetëm kush e ka drogën. Është kush e siguron, kush e financon, kush e transporton, kush e merr, kush e shet dhe mbi të gjitha kush i kthen paratë e drogës në pasuri që duken të ligjshme.

Megjithatë rëndësinë kësaj dosjeje ia japin edhe emrat që janë pjesë e saj. Nga Dritan Gjika, te Eldi Dizdari e Aldo Pacani. Të gjithë janë përmendur edhe në hetime ndërkombëtare, si personazhe të rëndësishëm të botës së narkotrafikut.

DRITAN GJIKA

Një operacion ndërkombëtar kundër trafikut të drogës, u zhvillua paralelisht në Ekuador dhe Spanjë, më 6 shkurt të vitit 2024. Ishte operacioni “La Pampa”, që u finalizua nga një hetim i udhëhequr nga Spanja që përfshinte Ekuadorin dhe mbështetej nga Europol. Ky operacion rezultoi një goditje e madhe në një rrjet të trafikut të drogës, të konsideruar me rrezikshmëri të lartë që furnizonte me kokainë vendet e Bashkimit Europian. Për të mbështetur aktivitetet në terren në ditën e zhvillimit të operacionit, Europol dërgoi dy ekspertë në qendrat koordinuese të ngritura në Marbella të Spanjës dhe në Quito të Ekuadorit. Europol financoi gjithashtu vendosjen e dy hetuesve spanjollë në Ekuador për të mundësuar koordinim të mëtejshëm midis autoriteteve kombëtare në terren në të dy vendet.

Autoritetet ligjzbatuese nisën një hetim për një biznesmen italian me origjinë argjentinase me banim në Marbella. Nga hetimet e mëtejshme rezultoi se kompanitë e tij përdorshin për fshehjen e aktiviteteve kriminale dhe transaksioneve financiare. Ata identifikuan lidhjen kriminale të biznesmenit me një shtetas shqiptar me banim në Ekuador. Shtetasi shqiptar kishte orkestruar importimin e kokainës nga Kolumbia në Ekuador dhe shpërndarjen e saj më pas në Europë. Informacionet operative tregonin se biznesmeni kishte një marrëveshje kontraktuale me furnitorët kolumbianë për të marrë 4 ton kokainë çdo muaj në Ekuador.

Europol thotë se organizata kriminale ka përdorur kompani ekuadoriane frutash si një front për të importuar kokainë në Europë, duke përdorur metoda të ndryshme transporti. Shpesh, sasi më të vogla kokaine fshiheshin brenda dërgesave me banane, qoftë edhe pa dijeninë e pronarëve të frutave, që varionin nga 15 deri në 40 kg. Pavarësisht sasive të ndryshme, kompania mohoi vazhdimisht çdo përfshirje në aktivitetet e trafikimit. Organizata ka realizuar transportin e ngarkesave të mëdha të kokainës nga porti i Guayaquil drejt portit të Algeciras dhe porteve të tjera europiane.

Gjatë hetimit, autoritetet ligjzbatuese në Shqipëri, Belgjikë, Ekuador, Holandë dhe Turqi sekuestruan disa ngarkesa të konsiderueshme kokaine, në total 3.2 ton. Drejtuesi i rrjetit kriminal luajti një rol kryesor në pastrimin e aseteve kriminale nëpërmjet investimit në biznese të ligjshme në Spanjë. Ai menaxhoi disa kompani, duke përfshirë një të fokusuar në prodhimin dhe importimin e bananeve nga Ekuadori në Europë, si dhe qendra sportive në Marbella, qendra tregtare në Granada dhe bare e restaurante të shumta. Shumë nga bashkëpunëtorët e tij kryesorë kishin lidhje të forta me Ballkanin Perëndimor dhe menaxhonin rrjetin e shpërndarjes, i cili ishte i përhapur në të gjithë Europën.

Operacioni kishte në shënjestër dy drejtuesit të këtij rrjeti kriminal, të konsideruar “High Value Targets”. Të dy liderët kishin orkestruar trafikun e drogës dhe pastrimin e të ardhurave të konsiderueshme kriminale në ekonominë legale përmes blerjes së pronave, automjeteve luksoze dhe mallrave. Deri më tani, hetuesit kanë lidhur objektivat me transaksionet financiare që arrijnë në 48 milionë euro në të gjithë Ekuadorin dhe Spanjën.

Europoli e nisi këtë bashkëpunim me Ekuadorin, si një nga qendrat kryesore të transitit për

dërgesat e kokainës në Europë. Përpjekjet e përbashkëta për të luftuar këto aktivitete kriminale në shkallë të gjerë, u formalizuan me nënshkrimin e një marrëveshje pune midis Europolit dhe Ekuadorit në tetor të vitit 2023. Ky kuadër i ri, ka rritur bashkëpunimin midis autoriteteve të zbatimit të ligjit nga shtetet anëtare të BE-së dhe homologëve të tyre ekuadorianë në luftën e përbashkët kundër kartelet shumëkombëshe të drogës.

Operacioni “La Pampa” u mbyll me 31 të arrestuar, nga të cilën 13 në Spanjë dhe 18 në Ekuador. Dy prej të arrestuarve konsiderohen si objektiva të rëndësishëm. U ushtrua kontroll në 66 adresa, 22 në Spanjë dhe 44 në Ekuador. Ndërsa u sekuestruan 25 automjete, 10 armë zjarri, pajisje elektronike të vlerësuara në rreth 13 milionë euro dhe gati 3 milionë euro cash në valuta të ndryshme, përfshirë edhe euro. Pronat që u vunë nën sekuestro kapin blerën e 48 milionë euro, 12 milionë euro në Spanjë dhe 36 milionë euro në Ekuador.

Operacioni ndërkombëtar i 6 shkurtit 2024 ishte në kuadër të një hetimi në lidhje me krimin e organizuar shqiptar, i përfshirë në trafik të dvshuar droge dhe pastrim parash. Sipas

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.